

VENDIM
Nr.802, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT RAJONAL TË STUDIMIT
“MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË “EU BUSINESS LAW”, NË FAKULTETIN
E DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 1051, datë 23.10.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Hapjen, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, të programit të përbashkët rajonal të studimit “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law”.*

2. *Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law” organizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit përfshirë edhe mikrotezën. Në përfundim të studimeve të këtij programi lëshohet një diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “EU Business Law”.*

3. *Në këtë program studimi të pranohen kandidatët, që kanë fituar diplomë të nivelit të dytë (DND) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND), si dhe diploma të tjera, ekuivalente me to.*

4. *Shfuqizuar*

5. *Kuotat e pranimit në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, do të jenë 40 studentë.*

6. *Tarifa e shkollimit do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.*

7. *Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.*

8. *Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha